



shqipëria Etnike



Në fund, ju nuk vlerësoheni se sa shumë keni ndërmarrë, por çfarë arrini në fund!

TRUMP

E martë
8 shtator 2020

Viti XXI
nr 165

Çmimi
30 L / 1 euro

E pavarur,
periodike

www.shqiperia-etnike.com
shqiperia_etnike@yahoo.com

English, page 14-15

Drejtor
Sokol Pepushaj



**MË 25 PRILL 2021
SHQIPTARËT
DO TA RRËZ-
OJNË...**

faqe 3



**SHQIPËRIA
NË KRIZË TË
THELLË POLI-
TIKE ...**
nga VOA
faqe 4



**CARLO BOLI-
NO PAGUHET
NGA TENDE-
RAT...**
faqe 8-9

EDITORIAL

**Pas Kosovës,
Donald Trump
do të merret me
Shqipërinë...**



nga Sokol Pepushaj

Donald Trump vëndosi drejtësinë e munguar në Ballkan, pa sforcime, pa bujë, krejt thjeshtë, krejt lehtë.

Gjithë ato përrallat Edi Ramçe apo Hashim Thaçëshe, paskan qënë tymçe idiotësh që mbushin llogaritë bankare me dollarë, dhe mëndjet e trulllosura të lindorëve, me urrejtje që gjenerohen gjeneratë pas gjenerate.

Po punët e mëdha nuk janë kaq të vështira sa i bëjnë burokratët e matrapazët. Kur merren seriozisht dhe pa interesa personale punët e mëdha, do të thotë në shërbim të njerëzimit, jetesës së lirë e në hapësira që Zoti nuk ka vënë kufinj, marrin formë e zhvillohen resurset e natyrës dhe gjësë përmbi natyrë.

Serbia nuk do ta njohë Kosovën dhe kërkesa historike e saj për dalje në det, u dekretoia me firmën e Trump-it, në pak minuta, pa asnjë sforcë, pa asnjë kundërshti. ... f / 6-7

Partia socialiste organizon bandat për manipulimin e zgjedhjeve parlamentare

faqe 2



EDITORIAL

**Tani Edi të puthet
me Milon...**



nga Andi Bushati

Rezultati i zgjedhjeve në Mal të Zi ishte një shpullë e papitur ndaj elitave të verbëra të perëndimit, ndaj burokratëve të Brukselit dhe atyre që e përdorën kryeministrin tonë Edi Rama, si një kamardare shpëtimi të minutave të fundit. Partia e Milo Gjukanoviçit, autokratit që e drejton vendin e tij si një ndërmarrje private, mori rezultatin më të keq të mundshëm në 30 vitet e fundit. Ndonëse social-demokratët arritën të dalin parti e parë, duke lënë me 2% mbrapa nacionalistët pro serbë, këta të fundit, nëse i'a dalin të thurin një koalicion në filigran me partitë liberale pro perendimore, mund ti japin fund regjimit të Podgoricës. Pak rëndësi ka se çfarë do të ndodhë më pas dhe nëse virtuozit Gukanoviç, mandati i të cilit si president përfundon në 2023, do të arrijë ti'a hedhë edhe kësaj radhe. Mesazhi që dhanë zgjedhësit e fqinjët tonë të vogël prej 620 mijë banorësh ishte i qartë: përrallat me pro dhe anti perendimorë nuk janë të njaftueshme për të qënë një faktor elektoral në vende që udhëhiqen nga autokratë. ... f / 5

O burra, te Piktori nuk ka tradhti, por antish- qiptari?

Nga Kim Mehmeti

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 në Maqedoni, Piktori dhe 'Rilindësit' e tij, i shpallën heronj kombëtarë shqiptarët që u rreshtuan me LSDM-në, me çka i nxitën shqiptarët e këtushëm të mos i votonin partitë e veta, por këtë parti maqedonase dhe, Zaevin ta bënin 'lider legjitim' të shqiptarisë së këtushme! f. / 11



VOA: Albania in deep political crisis, the only safe element so far is the election date

page 15

The Socialist Party organizes the bands to manipulate the Parliamentary Election

page 14



Partia socialiste organizon bandat për manipulimin e zgjedhjeve parlamentare

Zgjedhjet parlamentare të prillit 2021 po afrohen e Partia Socialiste duket se është në fuqi të plotë për të organizuar dhe përdorur të gjitha burimet dhe entitetet qeveritare për të siguruar "fitoren" e saj. Dhe shqiptarët jashtë vendit mund të duket se janë faktori vendimtar.

Që nga viti 1992, shumë shqiptarë janë larguar nga Shqipëria për shkak të pamundësisë së tyre për të jetuar këtu për arsye të ndryshme. Shumë u detyruan të iknin për shkak të persekutimit të tyre nga qeveria e Shqipërisë. Aktualisht llogaritet se 1/3 e shqiptarëve jetojnë jashtë atdheut: kryesisht në Itali, Greqi dhe Shtetet e Bashkuara. Por ekziston një dallim i qartë midis shqiptarëve që jetojnë në këto tre shtete. Shqiptarët në Greqi dhe Itali janë kryesisht punëtorë atje dhe janë nga Shqipëria e Jugut, të cilët në përgjithësi mbështesin Partinë Socialiste. Ndërsa shqiptarët në Shtetet e Bashkuara janë, në pjesën më të madhe, të arratisur politikë, katolikë, të përndjekur politikisht dhe janë nga Shqipëria e Veriut, të cilët mbështesin ose Partinë Demokratike ose Partinë Demokristiane të Shqipërisë dhe që duket se janë të mirëorganizuar dhe ekonomikisht mirë në diasporë. Vlerësohet se qindra mijëra dollarë vijnë nga diaspora e SHBA-së çdo vit.

Ndërsa Edi Rama dhe emisarët e tij vizitojnë Greqinë dhe Italinë në një përpjekje për të përfshirë shqiptarët atje në procesin zgjedhor, i cili u sjell dobi atyre, ata po bëjnë gjithçka që mundën për të parandaluar që shqiptarët në SH.B.A. të jenë në gjendje të suportojnë Partinë Demokratike të Shqipërisë. Sipas Lulzim Bashës, kreut të Partisë Demokratike të Shqipërisë, shumë familje nga Shqipëria e Veriut kanë kontaktuar zyrën e tij ose zyrrat lokale të partisë për t'u ankuar se agjentët nga NIS/SHISH (Shërbimi Informativ i Shtetit), kanë kryer vizita në shtëpitë dhe bizneset e tyre dhe i kanë marrë në pyetje në lidhje me kontaktet e tyre me anëtarët e familjes në SHBA, kryesisht duke u përpjekur të marrin informacion mbi planet e tyre për të udhëtuar, vizitat, çështjet e parave, etj. Disa kanë pohuar se mbi ta është ushtruar dhunë dhe u është thënë që nëse anëtarët e familjes së tyre kthehen nga SH.B.A., ata, të kthyerit, duhet të raportohen në autoritetet lokale.

"Agjentët e SHISH po vazhdojnë



punën e tyre të ndyrë për të detyruar edhe më shumë shqiptarë të veriut të largohen" tha Vjollca Anaj, e cila po drejton regjistrat e Partisë Demokratike në Prefekturën e Shkodrës që nga janari 2020 dhe po koordinon aktivitetet politike të partisë me diasporën. Sipas saj, shumë demokratë nga zonat përreth Shkodrës kohët e fundit i kanë detyruar të largohen. Ajo përmendi Viktor Popaj dhe vëllain e tij, Lodovik Popaj, një avokat i partisë, gjithashtu familjen Lera dhe Paulin Gjegaj, të cilët kohët e fundit u larguan nga Shq-

ipëria me të gjithë familjet e tyre.

Në maj të vitit 2020, sipas saj dhe informacion i verifikuar nga partia në Tiranë, agjentët e SHISH (NIS) hetuan transaksionet bankare të partisë për të përcaktuar nëse kishte dërgesa nga SHBA. Një zyrtar i lartë i partisë demokratike, i cili nuk dëshironte që emri i tij të përmendej këtu, konfirmoi se zyra e tij u bastis dhe se menaxheri i tij, Alfonc Rakaj, u arrestua, u mor në pyetje dhe u kërcënua nga këta agjentë sepse ai nuk do të zbulonte informacione për kontaktet e partisë me

Albanian Connect, Albanian Roots, the Lumaj Association, Christian Democrats in NY, etj.

"Kështu veprojnë ata: Ata përdorin autoritetin e tyre qeveritar për të frikësuar shqiptarët në emër të Partisë Socialiste. Nëse dikush nuk pajtohet me ta, ata do t'i arrestojnë, t'i integrojnë dhe t'i torturojnë. Ne madje kemi akuza për përdhunime të të dy gjinive nga këta agjentë dhe ato përdhunime janë kryer posaçërisht me qëllim të poshtërimit dhe tmerrimit të kundërshtarëve politikë, duke i bërë presion

që të kthehen kundër partive të tyre politike «tha znj. Anaj.

Megjithëse bëjnë përpjekje të shpesh-ta për të kontaktuar Partinë Socialiste për komente, ata nuk i pranuan kërkesat tona. Sidoqoftë, është e qartë se fuqia politike e shqiptaro-amerikanit është në këtë pikë e padiskutueshme dhe të dy palët do të duhet të merren me të. Dhe demokratët duhet të jenë në gjendje të marrin dhe mbajnë mbështetjen e tyre!



Më 25 prill 2021 shqiptarët do ta rrëzojnë qeverinë hajdute nga pushteti

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka dekretuar dje datën e zgjedhjeve parlamentare. Kreu i shtetit ka caktuar të dielën e 25 prillit 2021, si ditën kur shqiptarët do të drejtohen te kutitë e votimit për të zgjedhur parlamentin dhe qeverinë e re. Dekretimi i datës së zgjedhjeve vjen pas konsultimeve të kreut të shtetit me të gjithë krerët e partive parlamentare. Partitë e opozitës kërkuan nga kreu i shtetit që data e

vitet e ardhshme.

Sipas ligjit, fushata elektorale nis 30 ditë para datës së zgjedhjeve, por për krizën politike në të cilën ndodhet vendit, me dekretimin e datës vendi ka hyrë realisht në fushatë. Këto zgjedhje nuk do të jenë të zakonshme, si herët e tjera, për shumë arsye. Përballja politike pritet të jetë më e ashpër në gjithë këto vite pluralizëm. Rilindja dhe kryeministri Edi Rama

jtur pushtetin. Për ata fitorja me çdo kusht, përfshi vjedhjen e manipulimin është e vetmja mënyrë për t'i shpëtuar ndëshkimit. Por nuk do ketë asnjë fuqi që do ta ndalë ndryshimin e madh, ku PS-ja do kalojë në opozitë. Sondazhet tregojnë se do të marrin rezultatin më negative të 30 viteve pluralizëm.

Ndërkohë Opozita ndodhet në momentin më të mirë elektorale. Sondazhet flasin për një fitore spektako-

herë në proceset elektorale, partitë po hyjnë në fushatë kur ende nuk janë përcaktuar qartë rregullat e lojës me ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Ndryshimi i njëanshëm i Kushtetutës dhe shkatërrimi i marrëveshjes së opozitës reale me ndërkombëtarët, kanë kthyer dhe njëherë debatin për ligjin elektorale në pikën e nisjes. Rilindja kërkon që në këto zgjedhjet të mos ketë koalicione, me shpresë se votat



zgjedhjeve të ishte 18 prilli. Ndërkohë Partia Socialiste dhe kryeministri Edi Rama pretendonin që zgjedhjet të caktoheshin në fund të muajit maj. Presidenti ka vendosur një datë që nuk plotëson kërkesën e opozitës dhe as atë të qeverisë, por është brenda afatit kushtetues për dekretimin e datës së zgjedhjeve. Askush prej palëve nuk ka pasur rezerva për datën e përzgjedhur nga kreu i shtetit dhe në këtë mënyrë nga dje, ka rënë gongu për nisjen e garës elektorale. Pas rreth 7 muaj e gjysmë ose 230 ditësh qytetarët shqiptarë do të përcaktojnë se si do të jetë parlamenti i ardhshëm dhe kush do të jetë qeveria që do t'i drejtojë për katër

kërkojnë mandatin e tretë në situatën kur vendi përjeton krizën më të rëndë politike dhe ekonomike. Humbja e PS në këto zgjedhje nuk do të thotë vetëm falimentim i projektit të rilindjes, por dhe përfundim i karrierës politike të kryeministrit Edi Rama. Bashkë me kryeministrin dhe Rilindjen merr fund dhe gjithë mafia e tij që është instaluar prej vitesh. Për këto arsye, beteja e PS-së do të jetë më e ashpër se kurrë dhe siç kanë treguar zgjedhjet e fundit, rilindja nuk do të bëjë garë të ndershme. Gjithë fuqia ekonomike dhe lidhjet mes Rilindjes dhe kimit të organizuar do të hidhen në aksion për të mbrojtur pasuritë e për të mba-

lare, por sfida më e madhe e saj është që votat që do të marrin të mos manipulohen dhe të numërohen saktë. Këto 7 muaj partive të opozitës u duhet që të hartojnë strategji efikase për të mos lejuar që asnjë votë të mos shkojë dem dhe mbi të gjitha të mos tjetërsohet nga metodat rilindase. Kemi parë që Rilindja shkon në zgjedhje pa kundërshtarë, fut të vdekurit si votues dhe votat i numërojnë grupet kriminale. Me historinë e masakrimit të zgjedhjeve nga rilindja, në këtë fushatë do të ketë çudira të paimagjineshme, ndaj opozitës i duhet të ketë gati reagimin për çdo skenar. Këto zgjedhje kanë dhe një sfidë tjetër të madhe. Si rrallë

do ta nxjerrin parti të parë. Loja e pistë për të përçarë opozitën dhe krijimi i partive fiktive me rilindas të maskuar si "opozitarë" do të tensionojë dhe më shumë garën elektorale.

Por një gjë mbetet shumë e sigurtë: Humbja e Rilindjes është e sigurtë. Edhe biznesmenët dhe njerëzit afër Ramës flasin për humbje të madhe, ndaj kanë filluar të bëjnë llogaritë se si do ti përshtaten qeverisë së re të pas prill 2021.

Opozita do jetë e bashkuar dhe do sjellë emra të rinj në qeveri.

VOA: Shqipëria në krizë të thellë politike, i vetmi element i sigurtë deri tani është data e zgjedhjeve

Nga Zëri Amerikës:

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, dekretoi pothuaj 8 muaj përpara mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare pas një serie konsultimesh formale me partitë politike.

Presidenti Meta dekretoi që zgjedhjet për Kuvendin të mbahen më 25 prillin e ardhshëm në valën e një krize të thellë politike, që ka përfshirë vendin pas braktisjes së parlamentit nga opozita 20 muaj më parë.

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, deklaroi tre ditë më parë, pasi doli nga bisedimet me presidentin Meta se vendi ka nevojë të ngutshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

“Shqiptarët kërkojnë zgjedhje sot, jo nesër. Ata duan zgjidhje sepse janë të lodhur nga propaganda, nga dështimet dhe mashtrimet” – tha zoti Basha.

Kryeministri Edi Rama ka thënë në forumet politike se “Partia Socialiste synon një mandat të tretë si alternativa më e mirë qeverisëse e Shqipërisë”.


Data e zgjedhjeve u dekretua, por reforma zgjedhore nuk është përmbyllur ende as në letër as në zbatimin konkret. Si marrëveshja e qershorit ashtu edhe ndryshimet kushtetuese të korrikut kërkojnë një seri ndryshimesh në Kodin Zgjedhor dhe dhe në administratën zgjedhore.

Tensionet politike në Tiranë kanë arritur deri në atë pikë sa Fletorja Zyrtare nuk botoi një dekret të presidentit për zhvillimin e zgjedhjeve në tetorin e 2019.

KQZ dhe shumica socialiste i zhvilluan ato më 30 qershor, ndonëse rivalja kryesore, Partia Demokratike, i bojkotoi ato dhe nuk mori pjesë në zgjedhjet vendore.

Komisioni Zgjedhor duhet rindërtuar krejtësisht nga e para, dhe ende nuk kanë nisur një mori përgatitjesh të tjera, që kanë të bëjnë me administrimin elektronik të procesit zgjedhor.

Djegia e afateve ligjore dhe shtyrja e përgatitjeve dhe marrëveshjeve politike deri në ditët e fundit, hapja e fushatave elektorale shumë herët, si dhe mosnjohja e rezultateve zgjedhore janë pjesë e traditës problematike të politikës shqiptare, dhe i vetmi element i sigurtë deri tani është vetëm data e dekretuar e zgjedhjeve.



Tani Edi të puthet me Milon

Nga Andi Bushati

Rezultati i zgjedhjeve në Mal të Zi ishte një shpullë e papritur ndaj elitave të verbëra të perëndimit, ndaj burokratëve të Brukselit dhe atyre që e përdorën kryeministrin tonë Edi Rama, si një kamardare shpëtimi të minutave të fundit. Partia e Milo Gjukanoviçit, autokratit që e drejton vendin e tij si një ndërmarrje private, mori rezultatin më të keq të mundshëm në 30 vitet e fundit. Ndonëse social-demokratët arritën të dalin parti e parë, duke lënë me 2% mbrapa nacionalistët pro serbë, këta të fundit, nëse i'a dalin të thurin një koalicion në filigran me partitë liberale pro perendimore, mund ti japin fund regjimit të Podgoricës.

Pak rëndësi ka se çfarë do të ndodhë më pas dhe nëse virtuozit Gjukanoviç, mandati i të cilit si president përfundon në 2023, do të arrijë ti'a hedhë edhe kësaj radhe. Mesazhi që dhënë zgjedhësit e fqinjët tonë të vogël prej 620 mijë banorësh ishte i qartë: përallat me pro dhe anti perendimorë nuk janë të mjaftueshme për të qenë një faktor elektoral në vende që udhëhiqen nga autokratët.

Ndryshe nuk ka si shpjegohet që njeriu që i rezistoi Sllobodan Millosheviçit, ai që udhëhoqi me sukses referendumin për pavarësinë e vendit, duke marrë 55% të mbështetjes popullore, ai që njohu bashkë me SHBA, Gjermaninë e Britaninë, pavarësinë e Kosovës, ai që e futi vendin e tij në Nato dhe që është përpara të gjithë fqinjëve të Ballkanit perendimor në procesin e negociatave me BE, të fitojë gjithnjë e më pak vota në vendin e tij.

Kjo anë e medaljes e ish drejtorit të doganave të fundshekullit të kaluar, që e ktheu republikën e tij të vogël në një parajsë për mafiozët dhe kontrabandistët italianë të cigareve, nuk mund të mbulojë fytyrën e tij të vërtetë. Pas të përkëdhëlurit të perëndimit fshihej gjithnjë njeriu, emri i të cilit dilte në deponimet e të pënuarve të Camorra-s e Sacra Corona Unita-s. Artikuj të shumtë të mediave serioze e përshkruajnë atë si pronarin okult të disa hoteleve me 5 yje në bregdet. Ato e paraqesin familjen Gjukanoviç si padronen reale të vendit, ku për fatin e një prone shtetërore, në muret e qytetit të vjetër të Budvës, mund të vendosë një gjykatëse e lartë si Ana Kolarevic, që është motra e Milos, apo ku një bankë private mund të shpëtohet vetëm se është pronë e vëllait të presidentit, Ako Gjukanoviç.

Përpos pasurisë personale marra-mendëse që sipas "The independent" i



kalon 12 milionë euro, Gjukanoviç ka ngritur në vendin e tij një sistem krejt të kundërt me vlerat perendimore. Ai ka qenë, si një paraprijës i modelit putinian, gjashtë herë kryeministër, ka bërë dy tërheqje nga politika duke e drejtuar vendin nga zyra e kreut të partisë social demokrate dhe është votuar dy herë si president. Ai është treguar tejet represiv me mediat opozitare dhe shumë i ashpër me OJF që kanë denoncuar abuzimet e pushtetit të tij.

Dhe pavarësisht të gjitha këtyre atij i kanë ngjitur mbi shpinë etiketën e pro perendimorit, vetëm se di në mënyrë të shkëlqyer të luajë rolin e "yes man-it" që merr legjitimitetin nga jashtë për të zhvatur dhe sunduar

shumicën e qytetarëve të vet.

Pikërisht për këtë rezultati i zgjedhjeve të 30 gushtit përbën një risi. Ato dëshmuuan se kjo fabul nuk pi dot ujë përjetësisht. Dhe ndonëse është e vërtetë që një pjesë e malazezëve janë pro serbë (mbi 30% e popullsisë janë vetëdeklaruar si të tillë), ajo që ndodhi këtë të dielë nuk mund të shihet vetëm si një arenë beteje ku përplasen Rusia me demokracitë liberale.

Reduktimi drastik i votave pro Gjukanoviçit, kësaj radhe, tregon se një pjesë e popullsisë që dikur votonte pro tij, pikërisht ajo që nuk u gënje më nga etiketat pro dhe anti perendimor, nuk e përtyp dot pambarimisht demokracinë si një produkt që ia im-

ponojnë me dhunë nga jashtë, por si një realitet që do ta prekë dhe ta jetojë përditë.

E këtu edhe kryeministri Rama, që u keqpërdor me qëllim, duke u bërë thirrje në sllavisht qytetarëve që të votonin në favor të autokratit të tyre (video poshte) edhe ata ndërkombëtarë që e yshtën ta bëjë këtë në emër të stabilitetit, kanë marrë sinjalin e duhur.

Apeli për tu bërë bashkë rreth Gjukanoviçit nuk pati më shumë vlerë sesa një puthje me Milon. E në këtë kuptim ky është një mesazh për tu duartrokatur. Pasi tregon se as në këtë rajon, njerëzit nuk i durojnë dot më anti demokratët që shiten si pro perendimorë.



Pas Kosovës, Donald Trump do të merret me Shqipërinë, do të hetohet pasuria e gjithë hajdutëve të 28 viteve

“YLBERËT I BALKANIT” U KAPËRCYEN, ME HUMBJEN E MË TË PASURIT, MILO GJUKANOVIÇ, ME MARRËVESHJEN SERBI-KOSOVË DHE SHUMË SHPEJT, ME ARRESTIMIN DHE SEKUESTRIMIN E “HAJDUTËVE TË SHQIPËRISË”. TË FORTËT E DJESHËM NUK JANË TË FORTËT E SOTËM. EPOKA TRUMP KA NDRYSHUAR SHUMËÇKA.

Shkruan Sokol Pepushaj

Frikacak si gjithmonë, Edi Rama, këto ditë që presidenti amerikan Donald Trump u përfshi direkt në zgjidhjen e konfliktit Kosovë-Serbi, është mekur, është tmerruar, me zor nxjerr tingull dhe nuk shihet fare në publik. Është fshehur diku në një fshat, në një tunel, për të marrë vëmendjen si Kim Jong-un shumë shpejt, pas zgjedhjeve presidenciale në Amerikë.

Është pra, në fundin e tij të pashmangshëm, i hetuar, i survejuar dhe në radhë për të shkuar përpara drejtësisë.

KA HESHTUR EDI RAMA, KANË HESHTUR TË GJITHË GJYNAHTARËT E BALLKANIT KËTO DITË.


Donald Trump vëndosi drejtësinë e munguar në Ballkan, pa sforcime, pa bujë, krejt thjeshtë, krejt lehtë.

Gjithë ato përrallat Edi Ramçe apo Hashim Thaçëshe, paskan qënë tymçe idiotësh që mbushin llogaritë bankare me dollarë, dhe mëndjet e trullosura të lindorëve, me urrejtje që gjenerohen gjeneratë pas gjenerate.

Po punët e mëdha nuk janë kaq të vështira sa i bëjnë burokratët e matrapazët. Kur merren seriozisht dhe pa interesa personale punët e mëdha, do të thotë në shërbim të njerëzimit, jetesës së lirë e në hapësira që Zoti nuk ka vënë kufinj, marrin formë e zhvillohen resurset e natyrës dhe gjësë përmbi natyrë.

Serbia nuk do ta njohë Kosovën dhe kërkesa historike e saj për dalje në det, u dekretua me firmën e Trump-it, në pak minuta, pa asnjë sforcë, pa asnjë kundërshti.

Kosova dhe Serbia do të gjejnë zgjidhje të përbashkët për lidhjen e infrastrukturës hekurudhore Beograd-Prishtinë, me një port të thellë të Detit Adriatik, që nënkupton Shqipërinë.



KËTU PRESIDENTI TRUMP KA VËNË PIKË.

Do të merret pra edhe me Shqipërinë, me Shqipërinë që sot është plot milionerë të ardhur nga hiçi.

Kjo për Amerikën është një punë e lehtë, si pupël. Edi Rama me hajdutë do të arrestohen pa problemin më të vogël, do të rikthejnë çdo cent të vjedhur dhe do t'u hapin rrugën elitave të epokës Trump.

SE KJO EPOKË KA BËRË TASHMË EPOKË.

As luftrat e përgjakshme ballkanike, historikisht nuk kishin arritur ta zgjidhnin konfliktin e nxehtë të daljes së Serbisë në Det, por pak minuta në zyrën e Donald Trump-it, patën pushet të shkruajnë histori, t'u thuhet stop konflikteve, luftrave, pazareve të pista dhe mirseerdhe, normalizimit eko-

nomik në njërin nga cepat më të nxehtë të Globit.

KJO NDODHI SE DUHEJ TË NDODHTE.

Pikërisht se duhej të ndodhte kështu, aktorët e estradës së hajdutëve, Rama, Meta, Berisha, Basha, Kryemadhi, grupet kriminele dhe tërë anti-Trumpët, u veshën si kllounë, u maskuan, dhe nga frika se po ju vjen radha e hetimit të pasurisë, filluan kush ta urojë më shpejt e më bukur Donald Trump-in!

Kjo është vërtetë një skeç i neveritshëm, qesharak, që i bën këta aktorë edhe më të urryer nga populli i tyre proamerikan.

Po të mos ishte hajdut Edi Rama, po të mos ishte në panik, po të mos ishte afruar arrestimi dhe hetimi e kthimi patjetër i gjësë së vjedhur, nuk do ta uronte Trump-in, por do të dilte në të gjitha TV-të, edhe në arabisht e serbisht, e do të bërtiste; mos e votoni fatkeqësinë e popullit amerikan, siç ka



bërë kur mëndonte se pasuria e madhe e hajdutëve, është Ylberi që nuk kanë hap popujt ta kapërcejnë.

Por “Ylberët i Ballkanit” u kapërcyen, me humbjen e më të pasurit, Milo Gjukanoviç, me Marrëveshjen Serbi-Kosovë dhe shumë shpejt, me arrestimin dhe sekuestrimin e “Hajdutëve të Shqipërisë”.

Të fortët e djeshëm nuk janë të fortët e sotëm.

EPOKA TRUMP KA NDRYSHUAR SHUMËÇKA.

Nëse përpara katër viteve Edi Rama lëshonte kushtrimin nëpër të gjitha televizionet turke të Tiranës, kundër Donald Trump-it haptas, sot nuk e bën dot.

Sot milioneri Edi Rama, është maskuar në ruajtjen e kurrizit të konstantes, pra, racës së hajdutëve të 28 viteve të fundit, duke kaluar në vijën e parë si anti-amerikanë, Ilir Metën dhe Muslim Murrizin.

Mediat, shumë të kompromentuara dhe të paaferta profesionalisht, po eklipsojnë aq sa munden të vërtetat e sukseseve të Donald Trump-it në katër vitet e para të pushtetit të tij, dhe objektivat e mëdha të katër viteve të ardhshme.

Të fortët, të pasurit, parazitët, kriminelët, nuk qenkan asgjë para njeriut që po shkon afër interesave të veta, para drejtësisë që po vjen me hapa të sigurtë e po u thotë edhe gjykatësve, shkoni njëherë andej nga burgu, se keni dënuar njerëzinë kot, pa faj, pa bërë krime!



NDËRRONI PORTAT, DO TË THOTË ME FJALË TË THJESHTA.

Dhe është normale. Formalisht e kanë pranuar edhe vetë, edhe se kanë vjedhur, edhe se kanë diferencuar njerëzinë, edhe se kanë bërë krime.

I besonte përvojës edhe ky, si të tjerët përpara. Rama mëndonte ta shtynte kohën përtej kohës, si Berisha, Nano, Meta apo Majkoja i vogël me 5 milion dollarë në Qipron greke.

Marrëveshja Kosovë-Serbi ka hapur një epokë të re, epokë paqeje dhe normalizimi ekonomik e politik në tërë Ballkanin.

Pra, Ballkani do të jetë i qetë, do të

ketë zgjidhje dhe fizibilitet për ndarjen e Liqenit Gazivode, ose Ujmani siç njihet në Kosovë, si një furnizim i besueshëm i ujit dhe energjisë, gjë që pritej nga popujt dhe nuk shihej as në ëndrra nga liderët e krimbur në pasuri të dyshimta, madje të kriminalizuara, për shkak të konflikteve banale.

BESUESHMËRI DHE ENERGJI KËRKON SOT DONALD TRUMP.

Pas sheshimit të konfliktit historik, ku Serbia donte dalje në Det dhe Kosova njohje nga shteti Serb, Trump do të ndalet në Shqipëri.

Këtu është deklaruar botërisht nga

Amerika se do të bëhet drejtësi.

Trump-i kërkon arrestimin dhe sekuestrimin e gjithë hajdutëve të 28 viteve të fundit, siç ka thënë ambasadorja Yuri Kim, FBI shqiptare ka gati dosjet dhe do të arrestojë të gjithë peshqit e mëdhenj.

Po pra, peshqit e mëdhenj normalisht kanë të drejtë të jenë më të trëmburit, prandaj këto ditë Edi Rama ka heshtur e nuk po nxjerr zë.

Pas zgjedhjeve të 3 nëntorit në Amerikë, ku Trump pritet të korrë fitore historike, fillojnë arrestimet e të gjithë politikanëve e pushtetarëve, deri sot të paprekshëm dhe të krimbur në pasuri.



Carlo Bolino paguhet nga tenderat e Edi Ramës

“Karlo Bolino përfituesi direkt i parave publike me ndërhyrjen e Ramës ». Ky është pak a shumë refreni disa ditor i PD-së që në fillim e shtrou në formë pyetjeje, e më pas duke nxjerrë edhe faturat e pagesave për botuesin nga kompania Web & Development Communication me pronar Igli Gjelishtin. Sipas denoncimit të opozitës, “Web & Development Communication”, ka marrë një sërë tenderash shtetërorë nga Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe një pjesë të fitimeve nga ky biznes ia ka kaluar dy shoqërive të pronarëve të Report të TV, Karlo Bolino dhe Alba Malltezi. Ish deputeti Endri Hasa ka nxjerrë edhe faturat e pagesave që janë bërë dhe që tregojnë se gjatë periudhës shtator 2019 – mars 2020 dy kompanitë e çiftit Bollino – Malltezi kanë përfituar afro 1 miliardë lekë, nga përfituesi i tenderave shtetërorë, Igli Gjelishti.

Nuk ka dyshim se goditja e PD-së ndaj Bolinos është e ashpër dhe selektive. Këtë e vërteton si fakti se opozita nuk denoncon televizione më të mëdhenj kombëtarë që kanë përfituar në të gjitha regjimet . Këtë e dëshmon gjithashtu edhe fushata me meme denigruese që vijne era racizem gjuhesor që u zhvillua ndaj botuesit (shiko poshtë).

Por, pavarësisht këtij selektiviteti problemi mbetet: a janë fituara ndershmërisht ato para nga botuesi i Report TV?

Në denoncimin e PD hidhet vetëm dyshimi. Aty krijohet një lidhje logjike se ato para po i kalojnë një mediaje që i shërben pushtetit dhe që e arriti kulmin e saj me një sondazh që e nxorri Edi Ramën liderin botëror më të pëlqyer nga italianët. Por vetëm kaq. Nga sa ka denoncuar PD nuk shihet ndonjë provë konkrete që Bolino të ketë ndërhyrë në tendera dhe si pasojë e kësaj të jetë paguar nga Gjelishti. Pra në këtë kuptim gota e denoncimit të PD është gjysëm bosh.

Por ama edhe më bosh duket gota që servirin dy të akuzuarit nga PD-ja Bolino dhe Gjelishti. Lapsi.al nuk i kushtoi vend qëndror kësaj historie që ndërthen raportin e ndyrë të politikës me mediat, deri sa të dëgjonte edhe versionin e dy të akuzuarve nga opozita. Por pasi ata kanë folur, mund të thuhet pa frikë se nëse denoncimi i PD nuk është krejtësisht i mbështetur në prova, pra ai nuk vërteton trefikun politik të influencës së Bolinos për



tenderat e fituara nga Gjelishti, dëshmitë e këtyre të dyve janë edhe më pak bindëse.

Fillimisht Igli Gjelishti, ka treguar se ka punuar më parë dhe se ka miqësi me Bolinon. Se ai i është gjendur në një hall shëndetësor, se njeri që po e

akuzon ka abuzuar vetë me tendera pa garë kur në pushtet ishte PD. Të vetmin argument të dobët që ka dhënë është se e ka paguar Bolinon jo në dorë por me para të rregullta, duke i kaluar punë si nënkontraktor

Edhe Karlo Bolino ka mbështetur

pak a shumë të njëjtin version të fakteve. Pasi ka akuzuar PD-në që e përndjek prej 25 vjetësh, pasi ka ngritur problemin në princip për dhunë ndaj mediave të lira: ai ka pohuar, se Igli Gjelishti i ka kaluar një pjesë të punëve të tij për ti realizuar, për të

NË ITALIA, 1 MILIARD LEKA S'DO KISHA BËRË PËR GJITHË JETA



KURSE KËTU NE SHKIPERIA I BËRA PËR SHTATE MUAJI

cilat e ka paguar me faturat që përmend PD-ja:

“Faturat për të cilat flitet, janë bërë nga televizioni im dhe nga dega e tij IT ndaj shoqërisë së një inxhinieri të respektuar IT, të cilin prej vitesh e kam pasur furnizues dhe klient pub-

licitar, tani dhe mik, ortak në një shoqëri e mbyllur për mosprodhim fitimesh, dhe që në fund më kalon një pjesë të punëve të tij IT për të realizuar. Të ardhura plotësisht të ligshme, të deklaruara në tatime dhe për të cilat janë paguar TVSH dhe tatim

fitimi. “Skandali” i pretenduar mbyllet këtu...” ka shkruar në përgjigjen e tij Bolino.

Ajo që të bën përshtypje është fakti se në gjithë tekstin e gjatë që ka shkruar pronari i Report TV, sqarimi i vetëm përmbledhet në 3 falë: Gjelishti

“më kalon një pjesë të punëve të tij IT për të realizuar. Pyetja që nuk sqarohet nga dy përgjigjet që i jepen akuzave të PD-së është: Po pse një kompani siç e quan vetën pararojë në fushën e IT, që ka në rradhët e saj 25 profesionistë të zot, i kaloka punët dikujt që nuk ka të njëjtën ekspertizë në këtë lëmi? Për shoqëri?

Si mirnjohje për sëmundjen e dikurshme? Apo për motive të ngjashme me ato që pretendon opozita?

Si përfundim mund të thuhet se shpërthimi i kësaj historie nuk është një nga ato që vërtetojnë tërësisht një skandal politico mediatik, por që padyshim hedh hije të forta mbi ndryshimin dhe profesionalizmin e medieve që mbajë anën e qeverisë.

IMAGE & COMMUNICATIONS DEVELOPMENT				
Numri serial i faturës	Data e faturës	Blerje nga Subjekti	NIPT	Vlera ne lekë
74879455	04.09.2019	C-7-Kommunication Systems	L82403015F	59,120,357
74879456	20.09.2019	C-7-Kommunication Systems	L82403015F	24,000,000
74879457	14.11.2019	C-7-Kommunication Systems	L82403015F	5,615,568
22630039	15.01.2020	Media Content shpk	L21407033P	4,029,480
74879461	10.03.2020	C-7-Kommunication Systems	L82403015F	1,260,000
22630041	27.03.2020	Media Content shpk	L21407033P	1,260,000
				95,285,405

Një ngjarje që u harrua ndodhi në Washington

Nga Veton Surroi

A u angazhua diplomacia më e rëndë botërore për të prodhuar dokumente që nuk janë marrëveshje? Dhe si do ta vazhdojë Kosova tutje rutinën?

Në Washington, në ditën e katërt të shtatorit të vitit 2020, nga ekranet televizive dilte pamja e zyrës ovale të presidentit të SHBA-së.

Në tavolinën e tij ishte presidenti Trump, në të majtën e tij (në Tv) presidenti i Serbisë, Vuçiq, ndërsa në të djathtën kryeministri i Kosovës, Hoti. Nga ekranet dilte deklarata e presidentit amerikan se po nënshkruhej një marrëveshje historike. Disa orë më vonë u botuan dokumentet e nënshkruara, që dukeshin bukur larg të merituarit të quhen "historike". Ja një lexim i shpejtë.

1. Në Washington nuk pati marrëveshje Kosovë-Serbi:

Presidenti Vuçiq nënshkroi një dokument zotimesh, të dakorduara më herët me palën amerikane dhe me delegacionin e Kosovës. Ky dokument është juridikisht një ofertë e njëanshme e Serbisë, njohur pastaj në kontraktualitet me një letër njohëse nga presidenti Trump.

Të njëjtën gjë e bëri edhe kryeministri Hoti dhe me të njëjtën procedurë mori cilësinë e kontratës.

Serbia i premtoi SHBA-së se do të sillte ndaj Kosovës – dhe Hezbollahut, rrjetit 5G, 69 shteteve që kriminalizojnë homoseksualitetin, sipas pikave të dakorduara. Dhe Kosova bëri të njëjtën gjë, pra premtoi se do të sillte ndaj Serbisë, Hezbollahut dhe të tjerëve ashtu siç ka premtuar.

Presidenti Vuçiq dhe kryeministri i Kosovës nuk nënshkruan të njëjtën copë letre.

2. Në Washington nuk pati marrëveshje të njohjes së ndërsjellë:

Kriza politike kosovare e vitit 2020 u arsyetua me nevojën e formimit të një pushteti që do të marrë guximin të shkojë në Washington dhe të nënshkruajë marrëveshjen e njohjes së ndërsjellë mes Serbisë e Kosovës, të ndërmjetësuar nga presidenti Trump.

Në Washington shkoi delegacioni i Kosovës me mandat të vetëdeklaruar të nënshkrimit të marrëveshjes së njohjes së ndërsjellë ("sepse nuk shkojmë për gjë tjetër") e jo që nuk u nënshkrua një marrëveshje për njohje të ndërsjellë, por nuk u nënshkrua kur-

rfarë marrëveshjeje e ndërsjellë mes Kosovës dhe Serbisë.

3. Çka është "normalizimi ekonomik?"

Kryeministri Hoti dhe disa prej pjesëmarrësve deklaruan se atë që kishin nënshkruar është një rrugë që çon në "normalizim ekonomik", që pastaj do të çojë në "normalizim politik", i cili pastaj çon në njohje të ndërsjellë.

Kosova ka nënshkruar në Bruksel, më 2013-n, Marrëveshjen e parë për normalizim politik. Prej atëherë kanë kaluar shtatë vjet dhe marrëdhëniet nuk janë normalizuar. Ideja se në Washington duhet të fillojë një proces më 2020-n, që duhet të shpjerë në gjendjen e paravitit 2013, duket si



një humbje monumentale e kohës dhe resurseve të tjera.

4. Një shportë zotimesh të mira:

Kosova ka bërë zotime të mira për përmirësime infrastrukturore në marrëdhënie me Serbinë.

Nëse financat amerikane ia dalin dhe shihet leverdia ekonomike, do të ketë më shumë rrugë të mira që i lidhin Kosovën e Serbinë, më shumë hekurudhë, e posaçërisht hekurudhë që e lidh Adriatikun me të dyja vendet.

E njëjta gjë vlen edhe për studimin e fizibilitetit për shfrytëzimin energjetik të Ujmanit: shumë mirë që e bëjnë dhe kur ta përfundojnë, të dyja palët do të shikojnë se çka është ajo që u leverdis. Substanca e "normalizimit ekonomik" është kaq: një listë zotimesh që edhe po u kryen në tërësi e pa asnjë problem kanë bërë që njerëzit dhe mallrat të udhëtojnë gjysmë ore apo një orë, apo dy orë më shpejt prej një pike në pikën tjetër. Për fat të keq,

shpejtësia e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave nuk është problemi kryesor me të cilin zgjidhet "normaliteti" mes Kosovës e Serbisë. Është konflikti i papërfunduar mes dy vendeve.

5. "Mini-Shengeni" tash i mirë:

Ideja e një hapësire të "katër lirive" evropiane në Ballkanin Perëndimor, pos që u promovua me shumë pak finesë e sens politik, hasi në kundërshtim imediat në shumë qarqe në Kosovë.

Ndër më të zëshmit ishte rrethi politik i kryeministrit të tanishëm të Kosovës. Refuzimi ishte më shumë emocional sesa i shpjeguar mirë.

Kosova tash ka pranuar, emocionalisht, të jetë pjesë e "Mini-Shengenit". Diçka që ka mundur ta negociojë më

mbetur shumë afinitet.

7. Si duket Kopshti i trëndafilave:

Kosovarëve u është premtuar se do të nënshkruajnë diçka në Kopshtin e trëndafilave të Shtëpisë së Bardhë. Kopshti është sinonim për marrëveshje historike- më e madhja ka qenë ajo mes Arafatit dhe liderëve izraelitë, e më herët mes presidentit egjiptian, Sadat, dhe kryeministrit izraelit, Begin.

Kopshti është sinonim po ashtu për rolin e veçantë dhe të papërsëritshëm të Amerikës. SHBA-ja ka, si superfuqi, mundësinë e veçantë që të ndërmjetësojë vetë dhe me forcë, në mënyrë që të arrihen marrëveshjet e vështira.

Është si të thuash resursi më i madh, i rëndë dhe i kushtueshëm në diplomacinë botërore. Dje u shpenzua për diçka që nuk do të mbahet mend gjatë për ndonjë gjë konsekuente. Ka gjasa që dokumentet e nënshkruara, pas jo shumë kohësh, të përdoren si ilustrime shpottitëse për shpenzim të kotë të diplomacisë më të kushtueshme botërore, atë amerikane, në veçanti nëse zgjedhjet në Amerikë e ndërrojnë administratën.

8. Një vit për "normalizim", me rutinë:

Kosova e nënshkroi me dorë të veten se gjatë një viti politika e saj e jashtme nuk do të merret me avancim në njohje nga shtetet apo institucionet, por në "normalizim".

Pos këtij "ekonomik", të cilin u zotua se do ta bënte në Washington, e pret ai politik në Bruksel. Të hënën, më 7 shtator, kryeministri Hoti dhe presidenti Vuçiq do të takohen në Bruksel dhe tema e parë e këtij takimi, ndërmjetësuar nga z.Lajçak, janë "aranzhimet për komunitetet joshumicë".

Pas këtij formulimi qëndron çështja e bashkësisë së komunave serbe, për të cilat u zotuan dy kryeministra të mëhershëm të Kosovës, H.Thaçi dhe I.Mustafa, duke hapur për negociim shtyllat e rregullimit kushtetues të Kosovës.

Vendi ka pse të brengoset: procesi negociator po shkon me rutinën e vet disavjeçare, ku Kosova merr pjesë në një proces për të cilin as që është konsultuar, as pajtuar e as që diçka do të prodhojë.

herët, gjatë dy vjetëve të kaluar, tash e ka pranuar pa pyetur fare.

6. Faktori mysliman dhe Izraeli:

Si pjesë e rëndësishme e ngjarjes në Washington është njohja e Kosovës nga ana e Izraelit. Ky hap pozitiv për Kosovën, megjithatë, duket se e tejkalon vlerën që ka për Kosovën.

Sipas presidentit Trump, Kosova është shteti i dytë mysliman që e njeh Izraelin gjatë mandatit të tij, dhe "shumë shtete të tjera islamike dhe arabe" do të vazhdojnë më tutje. Nga ana tjetër, për Serbinë, kjo pikë është shndërruar në obligimin që Beogradi ta transferojë ambasadën e vet në Jerusalemin më 2021-n, diçka që shkon kundër politikës së përbashkët të jashtme evropiane.

Kosova kështu vendoset në një shportë identitare që nuk i përket arabe e islamike, ndërsa Serbia ftohet të ikë nga politika e jashtme evropiane, me të cilën edhe ashtu nuk i ka

O burra, te Piktori nuk ka tradhti, por antishqiptari?

Nga Kim Mehmeti

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 në Maqedoni, Piktori dhe 'Rilindësit' e tij, i shpallën heronj kombëtarë shqiptarët që u rreshtuan me LSDM-në, me çka i nxitën shqiptarët e këtushëm të mos i votonin partitë e veta, por këtë parti maqedonase dhe, Zaevin ta bënë 'lider legjitim' të shqiptarisë së këtushme!

Gjatë zgjedhjeve të sivjetme në Mal të Zi, Piktori nuk u rekomandoi shqiptarëve të atjeshëm të votonin për partitë e veta, por i këshilloi t'i mbeteshin besnik e të mos e tradhtonin Milon?!

Pra Piktori nuk i tha Malit të Zi e Maqedonisë se shtyllë e tyre bartëse shtetformuese ishin edhe shqiptarët, ai nuk u tha Milos e Zaevit se pa votën e shqiptarëve ata nuk vlenin gjë, por u tha shqiptarëve të atjeshëm se pa Milon e Zaevin ata nuk vlenin as pesë pare!

Po pra, duke vazhduar më tej mis-



ionin e tij për defaktorizimin e shqiptarisë, në zgjedhjet e sivjetme parlamentare në Maqedoni, Piktori dhe 'Rilindësit' e tij, e shpallën të arrirë monumentale, gënjeshtrën 'historike' të drejtuesit mashtrues të BDI-së, i cili premtoi kryeministër shqiptarë e mbeti vasalë i specaxhiut nga Strumica!

E në ndërkohë, askush nuk u tregoi burrështetasve shqiptarë në Prishtinë e

Tiranë, se qysh gjatë rënies së regjimit VMRO-BDI në vitin 2016, pra shumë vite para se këtë ta bënte kryetari i BDI-së, kryeministër shqiptarë të qeverisë teknike njëqind ditëshe – si zgjidhje më të duhur neutrale – kishin propozuar disa qarqe maqedonase!

Vite me radhë, Piktori dhe 'Rilindësit' e tij, i luftuan ditë e natë burrështetasit e Kosovës që nuk pranonin

të bashkëpunonin me Presidentin serb (përndryshe të dal nga kapota e Millosheviqit dhe një nga hartuesit e planit për shfarsosjen e të gjithë atyre që nuk i takonin fesë ortodokse serbe), pra i luftuan pa ndalë Kryetarin e VV dhe atë të AAK-së dhe e përkrahën 'vëllazërinë e Vuçiqit' – Presidentin e Kosovës dhe qeverinë e 'Listës Serbe', atë të LDK-së!

Pra rrënuesi i mbëmendjes shqiptare për vlerat kombëtare dhe për vetveten (i Teatrit Kombëtarë) i mbeti besnik 'Mini shengenit ballkanik' për të cilin edhe vetë serbët e sinqertë e pranojnë se është 'Federata e re e Serbosllavisë', me kryeqendër Beogradin, nga e cila federatë do përfitojë vetëm Serbia!

Por sidoqoftë duhet thënë zëshëm: o burra, nga e gjitha kjo që u tha më lartë për Piktoren dhe 'Rilindësit' e tij, nuk ka tradhti të vetëdijshme, por antishqiptari të qëllimshme!

Më në fund Piktori edhe nuk mund të jetë tradhtar, sepse asnjë veprim të vetin ai nuk e mat në kandin e shqiptarisë, por në atë të të huajve, sepse për të nuk ka vlerë ajo që është, por ajo që Vuçiqi e pëlqen në të dhe pse, siç duket, ai ndjehet si burrështetas që i takon popullit të gabuar.

Dënime nga gjykatat ndërkombëtare, Arben Malaj: Qeveria "Rama" e papërgjegjshme dhe arrogante

Ndëshkimi nga Arbitrazhi për qeverinë shqiptare, e cila duhet ti paguajë 44 milionë euro kompanisë greke, se i ndërpreu punimet e autostradës Tiranë-Elbasan, është komentuar edhe nga ish-ministri i PS-së, Arben Malaj.

Ai thotë se deri më tani, në kurriz të shqiptarëve janë 300 milion euro borxh që qeveria i ka marrë nga gjykatat ndërkombëtare. Ndërkohë janë 1.7 miliardë dollarë gjyqe ku Shqipëria mund të humbasë.

"Një vendim gjyqësor ndërkombëtar që vërteton se qeveria Rama është e pa përgjegjshme, arrogante dhe e babëzitur. Ja nga buroka "besnikëria neveritëse" e Taulant Ballës ndaj Ramës, të cilin po e vret politikisht dhe duhet ta "vras" edhe ligjërisht; modeli i qeverisjes së tij ku sundon korrupsioni dhe kapja e shtetit. Përse duhet shqiptarët të paguajnë këto vendime gjyqësore ndërkombëtare deri tani rreth 300 milion euro, ndërsa Taulant Balla kapardiset se do të jetë ministri ri i Rendit publik, çka do të përbente një skandal publik. Kjo është periudha më e keqe tragjiko-komiko që po kalojnë shqiptarët, edhe për faj të tyre", - shprehet Arben Malaj.



LAZER STANI PËR DIELLIN: KOLIQI DHE CAMAJ, MAJA TË LETËRSISË SHQIPE

Shkrimtari Lazër Stani komenton ekskluzivisht për gazetën Dielli, Organ i Federatës Panshqiptare të Amerikës VATRA, Neë York, debatin mbi figurën e Martin Camajt dhe Ernest Koliqit ku shprehet se dokumentet dhe dosjet e përpiluara nga sigurimi i shtetit, ky aparat monstruoz dhe kriminal, nuk mund të trajtohen si dokumente historike. Sigurimit nuk i ka interesuar kurrë e vërteta, po vetëm goditja, eliminimi, asgjësimi e diskreditimi i atyre që ai i konsideronte si kundërshtarë politikë të regjimit. Me Lazër Stanin bisedoi gazetari i Diellit Sokol PAJA.

BALTË MBI ERNEST KOLIQIN DHE MARTIN CAMAJN. PSE PIKËRISHT SOT KY DEBAT?

Nuk mund të them se është debat. Në këtë rast nuk ke se për çfarë të debatosh. Në këtë rast vetëm mund të refuzosh me përbuzje, riciklimin e akuzave të hartuara nga Sigurimi i Shtetit Komunist që synonte të denigrojë dhe të defaktorizojë dy prej personaliteteve kulturore më të rëndësishëm shqiptarë në shekullin e shkuar. Është një praktikë e njohur kjo e përdorur nga shërbimet sekrete Lindore, ndaj personaliteteve kulturore disidentë, që nuk pajtoheshin me regjimet e dhunshme të instaluar në këto vende. Vlerësimi për Ernest Koliqin, Martin

Camajn, por edhe Arshi Pipën, Petro Markon e ndonjë shkrimtar tjetër nuk mund të bëhet duke përdorur trillimet e Sigurimit të Shtetit ndaj tyre. Vepra e tyre letrare është dëshmia më e mirë e personalitetit të tyre letrar të padis-kutueshëm, por edhe dëshmi e atdashedurisë, e lidhjes se tyre shpirtërore me kombin dhe gjuhën shqipe. Joseph Brodsky shkruan se “për shkrimtarin ekziston vetëm një lloj patriotizmi, qëndrimi i tij ndaj gjuhës.” Nëse i shohim në këtë kontekst, unë nuk di patriotë më të mëdhenj se Koliqin dhe Camajn. Të dy kanë shkruar një shqipe të mrekullueshme. Nëse e lexon krijimtarinë e këtyre dy shkrimtarëve, gjen një lidhje shpirtërore të fuqishme me gjuhën, arketipin, shpirtin dhe identitetin shqiptar, të pa ndotur nga rrjedhat e historisë. Vetëm një njeri që e do shumë vendin e vet, gjuhën e vet, kombin e vet, mund të shkruajë një letërsi të tillë. Në Shqipëri nuk kemi shumë gjëra për të cilat mund të krenohesh, por emrat e këtyre dy shkrimtarëve, gjithmonë më kanë bërë të ndjehem krenar për vendlindjen time, vendin tim.

PSE SULMOHEN SHKRIMTARËT KUNDËRSHTARË TË REGJIMIT? PO ATA QË I SHËRBYEN REGJIMIT KOMUNIST?

Në librin tim të fundit “Rrugë pa krye” në njërën nga esetë kam shkruar ndër të tjera: “Dosjet e policisë

sekrete, dosjet e sigurimit të shtetit patën tmerruar njerëzit për dekada me radhë. Njeriu në këto dosje gjymtohej, shtrembërohej, tjetërsohej, ngarkohej me një mijë e një të zeza, fajë e krime të pabëra kurrë, deri sa një ditë ky njeri i dosjes e çonte njeriun e vërtetë në bankën e të akuzuarve, e shndërronte në viktimë të ndëshkimeve dhe dënimeve të padrejta”. Pikërisht kjo ka ndodhur, dosjet e përpiluara nga Sigurimi i Shtetit kërkojnë të çojnë edhe tani pas tridhjetë vjetësh, në bankën e të akuzuarve dy prej personaliteteve më të shquara të kulturës shqiptare, dy maja të ndritshme të letrave shqipe. Duket se “studimi” i prezantuar me dokumente të manipuluar dhe raporte të shkruara nga Sigurimi” është vetëm vazhdim i punës së nisur shumë vite më parë për të goditur këto personalitete, që me emrin dhe veprën e tyre i bënë hije shkëlqimit të rremë të diktaturës. Unë mendoj se dokumentet dhe dosjet e përpiluara nga Sigurimi i Shtetit, ky aparat monstruoz dhe kriminal, nuk mund të merren si dokumente historike. Sigurimit nuk i ka interesuar kurrë e vërteta, po vetëm goditja, eliminimi, asgjësimi e diskreditimi i atyre që ai i konsideronte si kundërshtarë politikë të regjimit. Dosjet e përpiluara prej tij janë të mbushura me shpifje, intriga, shtrembërimë, falsifikime e manipulime të së vërtetës. Ato dosje vetëm se dëshmojnë se sa kriminal, monstruoz dhe

antinjerëzor ishte regjimi në të cilin kemi jetuar; një ferr për njeriun dhe një paradis për të ligun, kriminelin, të pashpirtin, intrigantin, manipulatorin, gjithfarë lloj mostrash që për fat të keq toka jonë i ka prodhuar me shumicë.

ÇFARË PËRFAQËSOJNË CAMAJ E KOLIQI NË LETËRSINË E KULTURËN SHQIPTARE?

Koliqi dhe Camaj janë individualitete krejt të veçantë të letrave shqipe, vijnë si zë autentik i shpirtit shqiptar, të pa ndotur e të pa përcudnuar nga masakra që iu bë kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet. Është kjo arsyeja ndoshta që ata urrehen nga bartësit ende aktivë të ideologjisë së diktaturës.

A E DËMTON SHOQËRINË DHE SHKENCËN KJO HAPJE ARKIVASH NGA NJERËZ JO KOMPETENTË?

Shoqërinë e dëmton sigurisht. Akte të tilla poshtëruese i bëjnë njerëzit të demotivohen, të ndjehen të zhgënjyer në vendin e tyre. A këta jemi ne? Nëse jemi kështu, e meritojmë këtë fat që kemi, ndaj hajt të ikim nga sytë këmbët, të shpëtojmë kush mund të shpëtojë, në mos veten, të paktën fëmijët. Ndërsa për shkencën është vështirë të flitet. Ajo qëndron përtej këtyre banaliteteve.

ÇDO TË THOTË TË SULMOHEN MITET LETRARE TË NJË KOMBI?

Historia jonë është e mbushur me barbarizma të tilla. Është përçmuar letërsia e vjetër shqipe dhe krijuesit e saj, autorët e Rilindjes, Faik Konica dhe Gjergj Fishta, At Anton Arapi dhe Ernest Koliqi e shumë e shumë shkrimtarë të tjerë. Komunizmi si filozofi në ADN-në e vet ka urrejtjen, sepse është i mbështetur mbi urrejtjen klasore dhe konfliktin që lind midis klasave të një shoqërie për shkak të kësaj urrejtjeje. Kjo ka sjellë shumë shkatërrime në vendin tonë, Shqipërinë. Dhe që për fat të keq është ende e pranishme, si sindromë, si lëngatë, që bren vlerat dhe virtutet e kombit. Një komb matet me njerëzit e tij të shquara, shkruante Ernesto Sabato. Nëse ne si komb i asgjësojmë njerëzit tanë më të shquara, e në mes tyre edhe Koliqin e Camajn, atëherë me çfarë do të matemi, me partizanin e vogël Velo? Megjithatë, në fund dua të shtoj se letërsia e mirë është superiore, është e paasgjësueshme. Të tillë janë edhe Koliqi e Camaj si autorë të një letërsie të tillë.



LUFTA E HARRUAR E KOPLIKUT, NË 100 VJETORIN E SAJ

Bazuar mbi fakte të vërteta burimore të historiografisë shqiptare, apo relacioneve zyrtare e jo zyrtare si dhe të trashëgimisë gojore, Lufta e Përgjakshme e Koplikut, njihet si qëndresa më heroike e popullit shqiptar, ku pavarësisht humbjeve...”fitorja u takoi shqiptarëve që bënë një luftë të drejtë dhe mbrojtëse” - pohoi në fjalën e tij përshëndetëse z. Ramadan Likaj, ish Kryetari i Bashkisë Koplik të Malësisë së Madhe, në simpoziumin shkencor të organizuar me 5 tetor 2009.

E solla në vëmendje këtë simpozium si të vetmen përkujtimore për një referencë të mirëfilltë shkencore të deri tanishme si dhe për faktin se ky vit përkon me 100 - vjetorin e kësaj qëndrese heroike të malësoreve në mbrojtje të trojeve etnike kundër pushtuesit më të egër Serbo - Malazez. Ngjarje historike kjo, që ka merituar dhe meriton një vëmendje të shtuar jo vetëm nga malësorët, por edhe nga mbarë qarqet akademike shkencore nacionale zyrtare e jo zyrtare.

Megjithëse e nxitur nga politikat dashakeqese të ndërnacionale, të cilët u detyrohen shumë çka shqiptarëve, kjo luftë është cilësuar nga diplomacia evropiane e asaj kohe si një nga luftërat më të përgjakshme të popullit shqiptar dhe qëndresa më e pathyeshme heroike e malësoreve trima kundër fqinjëve gjakatarë Serbo-

Malazeze, të cilët edhe pse të mbështetur nga klanet politiko - Ruse, arritën të depërtojnë në malësi, jo me force, por me dredhi, duke thyer kështu shtigjet dhe priat e vigjilencës së vullnetarëve malësor.

Ky vit jubilar meritonte një vëmendje të shtuar nga pushteti vendor dhe ai qendror, pasi të vlerësosh LUFTEN E KOPLIKUT, është një obligim mbarë nacional, për faktin se, falë kësaj lufte, të gjitha këto territore të lara me gjak në atë qëndresë heroike gjenden brenda hartës së sotme politike të Shqipërisë.

Bazuar në një nga dorëshkrimet e Gjon Zekës “Nëpër lufta për liri” të përmbledhura në librin “Kopliku në vitin 1920 - 1921”, del në pah edhe fakti se si serbo - malazezët, në pamundësi force për të thyer qëndresën e malësorëve, përdoren serish dredhitë. Të ndihmuan nga kaçaket heretikë, të cilët thyen lidhjet e malësisë, duke u shtirur dhe shitur më parë, u hapën dy shtigje pushtuesve të huaj të hynin në Kastrat dhe krahinat përreth “kah Qafa e Padigorës dhe Qafa e Gëlqerës së brisë së

Veleçikut tue marre Shkrelin”.

Kjo lëvizje tinzare dhe djallëzore i gjeti malësorët jo fort të përgatitur, çka i dha përparësi forcave sllavo-malazeze për të pushtuar një pjesë të mire të malësisë e duke kthyer Kastratin në një vatër të përgjakur e të shkrumbuar gjatë marshimit të tyre drejtë Shkodrës. Me të mbërritur

këtë luftë të përgjakur, përveç qëndresës heroike, u dëftua edhe njëherë uniteti i pa lëkundur ndërmalësor dhe ai mbarë shqiptar.

Të habit fakti se si kjo luftë e përgjakshme është lënë në hije të plotë nga mediat e shkruara të asaj kohe, relacionet zyrtare e jo zyrtare e deri tek materialet shkencore, të cilat vende-vende i kapërcejnë këto dy vite duke i lënë pa një dëshmi historike, ose kalohet me një përshkrim krejt empirik. Ajo që të habit ende më shumë është se, edhe ato pak materiale të shkruara të asaj kohe janë të censuruara nga regjimi zogist, i cili qëllimisht dhe me tendence nga ai mllef (urrejtje) që mori ndaj malësoreve dhe organizatoreve, pikërisht në këtë luftë rreth përplasjes që pati me ta, ku desh i mori dhe jetën si i dyshuar pro sllav e pluhurosi këtë ngjarje të lavdishme historike me mllefin e tij hakmarrës”. Prele Milani. “Atentati që tronditi dy shtete”

Veç kësaj po ti referohemi edhe historiografisë shqiptare mbetemi serish të zhgënjyer, se sa empirike paraqitet kjo luftë. E gjitha e përmbledhur në një kapitull të vetëm e me krejt pak material të shkruar. Dhe serish e censuar edhe nga qarqet akademike të kohës së monizmit.

Dhe ajo që i vuri vulën e mos vlerësimi të kësaj lufte, ishte heqja e memorialit (lapidarit) nga Rilindja Urbane prej qendrës së qytetit të Koplikut, duke shuar kështu çdo dëshmi që identifikon gjakun e derdhur të atyre malësoreve dhe vullnetareve trima shqiptar.

Megjithatë dëshmitarët e asaj qëndrese kanë mundur të nxjerrin në dritë shumë fakte e ngjarje të pathëna, duke u dhënë zë të vërtetave historike të asaj qëndrese heroike.

Merita të veçanta për këtë zbardhje kanë malësorët e Malësisë së Madhe, intelektual të Dukagjinit dhe qytetarë të nderuar të Shkodrës, dashamirës të malësisë dhe të vërtetave historike, të cilët i kanë sjell këto kujtime dhe gojëdhëna në formë dorëshkrimesh publicistike dhe librash me vlere.

**LUFTA E KOPLIKUT
ZGJOI UNITETIN NDËR
VËLLAZËROR
TË SHQIPTARËVE**

Kushtrimi i kësaj lufte kaloi përtej maleve të malësisë, duke ngjall në zemrat e krahinave të Veriut frymën nacionale dhe vullnetin e mirë për tu gjete pranë vëllazërisë së këtyre fiseve. Fryme kjo që vuri në lëvizje edhe qarqet akademike e patriotike e deri tek organizmat shtetërorë, të cilët u angazhuan edhe fizikisht në këtë qëndresë. Sipas gojëdhënave dhe materialeve të shkruara në të hyrë të muajit gusht, pranë shtabit të mbrojtjes të vendosur në Çezme të Koplikut, në hanin e Zef Luc Mullisit vjen Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu dhe Plaku i Maleve, patrioti shqiptar Bajram Curri.

Sipas Nikoll Spathari, «Malësia e Madhe si e njoha unë»

Si pasojë e jehonës së qëndresës dhe vështirësive të panumërta, që përjetuan malësoret në këtë përballje, në ndihmë të tyre u angazhuan shumë vullnetarë, të cilët u thirren në këtë kushtrim nga patriotet më të flaktë të asaj kohe, arritën të mirë koordinojnë mësymjet, si dhe të mbajnë të pathyeshme llogoret luftarake. Komandant i Përgjithshëm i forcave Vullnetare u caktua Sulçe Beg Bushati. Nikoll Spathari (po aty).

Megjithëse me pasoja të rënda jetike dhe ekonomike, kjo luftë bëri të triumfojë dhe njëherë uniteti ndër vëllazëror i shqiptarëve, të cilët nuk u tërhoqën deri në pikën e fundit të frymës së tyre.

TË NDEROSH LULFTEËN E KOPLIKUT ËSHTË DETYRË MORALE DHE ZYRTARE E PUSHTETIT VENDOR DHE QËNDROR

Të përkujtosht Luftën e Koplikut, është nderim për gjakun e derdhur të malësorëve trima, vlerësim i asaj ndihme vëllazërore të mikut dhe kujtese historike ndaj barbarizmave të armikut.

26 korriku shënon 100 vjetorin e kësaj lufte dhe nuk vihet re asgjë që identifikon një punë në ecurinë e saj si projekt për ti vënë pikat mbi “i” kësaj kujtese të përmasave dhe vlerave të mëdha historike.

Heshtje totale nga organizmat zyrtare të pushtetit vendor.

Heshtje edhe nga shoqatat apo institucionet e edukimit, në një kohë kur trumbetohet me të madhe dhe flitet pafund për vlerat e turizmit kulturor.

Paafëzia e nëpunësve zyrtare, jo kompetent për këtë punë, del haptazi për aq kohë sa arrijnë të sajojnë festa frutash me gjemba dhe të anashkalojnë rëndësinë dhe peshën e vlerave historike e kulturore të Malësisë së Madhe.

Në këtë 100 vjetor, Lufta e Koplikut me gjithë lavdinë e saj, shuhet plotësisht nga kujtesa historike e Malësisë së Madhe, duke u mohuar dhe përbaltur nga arroganca heretike e të paafëtëve që hanë dhe flenë në postet e gabuara të administratës së sotme në Malësi.

Përgatiti **Rita Shkurtaç,**
22 korrik 2020



në Koplik këto forca barbare, u ndeshën me rezistencën e fortë të malësoreve dhe vullnetarëve të mirë organizuar e të pamposhtur në kauzën e tyre. Ja vdekje ja liri!

**RËNDËSIA E LUFTES
SË KOPLIKUT E MBULUAR
NGA PLUHURI
I SHITRESËZUAR POLITIK**

E përfshirë në një hulumtim mbi vullnetarët e Dukagjinit, që morën pjesë në Luftën e Koplikut, arrita të konstatoj, se sa pak materiale të shkruara gjenden në arkivat tona burimore shkencore për këtë ngjarje të rëndësishme historike, ndërkohë që prej tre dekadash trumbetohet me të madhe për rishikimin dhe rivlerësimin e historisë së popullit shqiptar.

Në këtë kuadër po t'i bëhej një rivlerësim historik edhe Luftës së Koplikut, historiografia shqiptare do ta kishte ngritur me kohë këtë luftë në nivelet më të larta për nga rëndësia dhe pesha që mbajti në momentin kyç të rënies së plotë të Perandorisë Osmane, si dhe për faktin se në

The Socialist Party organizes the bands to manipulate the Parliamentary Election

As the Parliamentary Election of April 2021 approaches, the Socialist Party appears to be in full force of organizing and utilizing all the government resources and entities to secure its “victory”. And the Albanians abroad may appear to be the deciding factor.

Since 1992, many Albanians have fled Albania because of their inability to live here for various reasons. Many were caused to flee because of their persecution by the government of Albania. It is estimated that 1/3 of Albanians live abroad now: mostly in Italy, Greece, and United States. But there is a clear distinction amongst the Albanians living in these three countries. The Albanians in Greece and Italy are mostly workers there and are from the southern Albania, who generally speaking, support the Socialist Party. Whereas the Albanians in the United States are, for the most part, political escapees, Catholics, politically persecuted and from the northern Albania, who support either the Democratic Party or the Christian Democratic Party of Albania and who appear to be well organized and well financed in Diaspora. It is estimated that hundreds of thousands of dollars come from the US Diaspora every year.

While Edi Rama and his emissaries visit Greece and Italy in an effort to get the Albanians there involved in the election process, which benefits them, they are doing everything they can to prevent Albanians in the US from being helpful to the Democratic Party of Albania. According to Lulzim Basha, the leader of the Democratic Party of Albania, many families from the northern Albania have contacted either his office or their local party offices to complain that agents from the NIS/SHISH (National Informative Services), have paid visits to their houses and businesses and have interrogated them about their contacts with their family members in the USA, mostly trying to elicit information on their plans to travel, visits, money issues, etc. Some have alleged that they were beaten and told that if their family members returned from the US, they,



the returnees, most report to the local authorities.

“SHISH agents are continuing their dirty work of forcing even more northern Albanians to flee” said Vjollca Anaj, who is running the Democratic Party’s registration drives in the Shkoder Prefecture since January 2020 and is coordinating the party’s political activities with Diaspora. According to her, many democrats from surrounding areas of Shkoder have recently been forced to leave. She mentioned Viktor Popaj and his

brother, Lodovik Popaj, an attorney for the party, the Lera family and Paulin Gjergjaj, who recently fled Albania with their entire families.

In May 2020, according to her and verified by the party in Tirana, SHISH (NIS) agents investigated the bank transactions of the party to determine if money from USA had been donated. A senior democratic party official, who did not want his name to be mentioned here, confirmed that his office was raided and that his manager, Alfonc Rakaj, was detained, interrogat-

ed, and threatened by these agents because he would not reveal information about their contacts with Albanian Connect, Albanian Roots, the Lumaj Association, Christian Democrats in NY, etc.

“This is how they operate: They use their government authority to intimidate Albanians on behalf of the Socialist Party. If anyone disagrees with the, they will arrest, integrate, bet, and torture them. We even have allegations of rapes of both genders by these agents, and those rapes are specifically committed for the purpose of humiliating and terrifying political opponents, pressuring them into turning against their political parties” said Ms. Anaj.

Though we made several efforts to contact the Socialist Party for comments, they declined our requests. Nevertheless, it is obvious the political power of the Albanian-American is at this point undisputed and both parties are going to have to deal with it. And the Democrats better be able to obtain and maintain their support!



VOA: Albania in deep political crisis, the only safe element so far is the election date

From VOA

The President of Albania, Ilir Meta, almost 8 months ago decreed the holding of the general parliamentary elections after a series of formal consultations with the political parties.

President Meta decreed that the elections for the Assembly will be held on the upcoming April 25 in the wave of a deep political crisis, which has involved the whole country after the abandonment of the parliament by the opposition 20 months ago.

The leader of the Democratic Party, Lulzim Basha, stated three days ago, after coming out of the meeting with President Meta that the country urgently needs free and fair elections.

“Albanians want elections today, not tomorrow. They want solutions because they are tired of propaganda, failures and frauds” - said Mr. Basha.

Prime Minister Edi Rama has said in political forums that “the Socialist Party aims for a third mandate as the best governing alternative of Albania.”

The date of the elections was decreed, but the electoral reform has not yet been concluded either on paper or in concrete implementation.

Both the June agreement and the July constitutional amendments require a series of changes to the Electoral Code and to the election administration.

Political tensions in Tirana have reached the point that the Official Gazette did not publish a presidential decree on the conduct of elections in October 2019.

The CEC (Central Election Commission) and the Socialist majority held them on June 30, although the main rival, the Democratic Party, boycotted them and did not take part in the local elections.

The Electoral Commission needs to be completely rebuilt from scratch, and a host of other preparations have not yet begun, which is related to the electronic administration of the electoral process.

Passing the legal deadlines and postponing political preparations and agreements until the last days, opening election campaigns too early, as well as not recognizing election results are part of the problematic tradition of Albanian politics, and the only safe element so far is only the decreed election date.



Helmimi i opozitarit rus, Alexei Navalny/ Merkel reagon për herë të parë, ultimatum Rusisë: Ndëshkoni përgjegjësit

Pas helmimit të opozitarit rus Alexei Navalny, ka reaguuar për herë të parë kancelarja, Angela Merkel, ku ka lëshuar ultimatum Rusisë që të hetojë ngjarjen.

Këtë të hënë mjekët gjermanë kanë pohuar se ekzaminimet kanë treguar se lideri i opozitës ruse ishte helmuar para se të humbte ndjenjat në një aeroplan në Rusi javën e kaluar.

“Ata që janë përgjegjës duhet të identifikohen dhe të ndëshkohen,” tha Merkel në një deklaratë të përbashkët me ministrin e Jashtëm Heik Maas.

“Rusia ende nuk e ka komentuar pretendimin e mjekëve gjermanë. Krem-

lini tha të premten se ishte ende e paqartë se si Navalny u sëmur dhe se testet fillestare treguan se “ai nuk ishte helmuar”.

Ky incident mund të përkeqësojë edhe më tej marrëdhëniet tashmë të këqija midis Moskës dhe vendeve evropiane, të cilat e kanë akuzuar atë në të kaluarën për sulm ndaj disidentëve të Vladimir Putin, të cilat Rusia i mohon.

Mjekët në spitalin e Siberisë, që trajtuan së pari Navalny, thanë sot se ata kishin shpëtuar jetën e tij, por “nuk kishin gjetur gjurmë helmi në trupin e tij”.



“Qeveria humbi gjyqin, 44 milionë euro kompanisë greke” / PD: Shqiptarët duhet të paguajnë faturën për mikun e Ballës dhe Ramës

“Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar ka dënua shtetin shqiptar pas padisë së kompanisë greke Aktor, e cila kishte fituar tenderin për të kryer punimet në rrugën Tiranë-Elbasan”, deklaroi nga radhët e PD-së, Gent Strazimiri.

Strazimiri shprehet se 44 milionë euro është fatura e re që do të paguajnë shqiptarët për Edmond Begon, mikun e Taulant Ballës dhe të Edi Ramës.

“Kompania greke ishte kontraktuar nga qeveria shqiptare për të bërë punimet shtesë, por Edi Rama në mënyrë që të favorizonte kompaninë e mikut të tij dhe të Taulant Ballës “Inerte Ekspres” të Begos vuri gjoba, bëri presion dhe tentoi që të largonte kompaninë Greke Aktor e cila mbasi mori nënkontraktorët e imponuar nga qeveria u largua pa marrë asnjë pagesë. Për këtë arsye Aktor iu drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar duke paditur qeverinë shqiptare. Me 1 shtator 2020, pra vetëm 5 ditë më parë, Arbitrazhi shpalli vendimin që i jep të drejtë kompanisë greke dhe dënon Shqipërinë ta dëmshpërblejë atë me plot 44 milion euro”.

Më tej ai shton:

“Pra, qeveria shqiptare, për të favorizuar kompaninë e Edmond Begos me shokë ngarkon në këtë mënyrë buxhetin e shtetit shqiptar i cili sigurohet me taksat e qytetarëve shqiptarë.

Edi Rama në 2013 mori një rrugë

të përfunduar dhe shpenzoi 138 mln euro kosto shtesë: nga 312 milion euro e parashikuar në fillim, kostoja e rruges perfundoi në 450 milion euro.

Pa asnjë bilanc në punë publike, pa asnjë rrugë të shtruar, në 8 vjet edhe ato investime publike që gjetën të gatshme ose i dhanë me koncesion ose i përdorën për ti vjedhur. Në një kohë kur mijëra qytetarë jetojnë ende në çadra dhe 99 përqind e shqiptarëve vuajnë krizën e thellë ekonomike nga keqqeverisja, Edi Rama u shton një haraç të ri në kurriz. 44 milionë euro nuk i paguan as Edi Rama, as Taulant Balla dhe as Edmond Bego i cili mori miliona euro për tenderin e përfundimit të rrugës Tiranë-Elbasan. 44 milionë eurot e kompanisë greke do të paguajnë një më një çdo qytetar i Shqipërisë nëpërmjet taksave që do shtohen. Kjo faturë që rëndon në xhepat e shqiptarëve dhe të ekonomisë së Shqipërisë, vjen vetëm pak muaj pas një tjetër ndëshkimi nga Arbitrazhi Ndërkombëtar. Për shkak të banditizmit të Edi Ramës dhe interesit të Rilindjes, kjo gjykatë e ndëshkoi Shqipërinë dhe shqiptarët me faturën 110 milion eurove për një dëm shkaktuar pa shkak ligjor, biznesmenit italian Francesco Bechetti, media kritike dhe

bizneset e të cilit u mbyllën arbitrarisht nga qeveria e rilindjes sapo erdhi në pushtet. Janë plot 153 milion euro për dy muaj që Shqipëria duhet t’u paguajë vetëm dy kompanive si pasojë e vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar. 153 milionë euro të cilat do të paguajnë shqiptarët, jo Edi Rama dhe miqtë e tij që sot ndajnë fitimet ndërsa shqiptarët vuajnë urinë”.

Për ta përmbyllur me: “Për shqiptarët ka vetëm një rrugë që të shpëtojnë nga mali i borxheve që po rrit çdo ditë keqqeverisja e Edi Ramës dhe banda e

tij e Rilindjes. Rruga është largimi një orë e më parë i kësaj qeverie dhe hapja e një rruge për një qeverisje normale që mendon për popullin, ekonominë, jo që i zhyt ata në borxhe pa fund. Çdo orë më shumë që qëndron në pushtet, çdo herë më shumë që hyn në zyrën e Kryeministrit, Edi Rama plaçkit, tashmë, edhe mjerimin e shqiptarëve. Të nderuar qytetarë! Na kushton të gjithëve më lirë ta shporrim sa më parë e t’i heqim nga duart e feliqura, një pushtet që s’e ka marrë me votë!”

